



AKT-THEMELIMI
PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR " KAPPA-OIL" Sh.p.k

Ne, **RESUL AGUSH RESULI** I datelindjes 02.04.1960, lindur dhe banues ne Shijak-Durres, i pajisur me Pass Nr 0375268; **ENKELED NURI LASKO**, i datelindjes 24.04.1973, lindur dhe banues ne Durres, i pajisur me Pass 0442170 ; **KRENAR NURI LASKO**, lindur dhe banues ne Durres, i datelindjes 25.07.1968, i pajisur me Pass 0028855, ortak te shoqerise tregtare ne mbeshtetje te Ligjit Nr 7512 dt 10.08.1991 dhe te ligjit nr 7638 dt 19.11.1992 dhe te Ligjit Nr 7667 date 28.01.1993 vendosem te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "**KAPPA-OIL**" SHP.K

NENI 1

Kjo shoqeri tregtare do te kete seline e saj ne Tirane ne adresen : **Shijak - Durres**. Kjo shoqeri mundet te hap zyra, dege, perfaqesi e filiale ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 2

Kohezgjatja e veprimtarise eshte parashikuar per 30 (tridhjetë) vjete.

NENI 3

Shoqeria "**KAPPA-OIL**" ka si objekt te veprimtarise se saj:

- *- prodhim akumulatore
- *- prodhim perpunim vajra lubrifikuese
- *- tregeti me shumice e pakice, importim i mallrave industrial e ushqimore,.

NENI 4

Kapitali themelues i shoqerise ne momentin e krijimit te saj do te jete 100.000 (njqindemije) leke . Kapitali eshte i ndare ne 100 pjese me 1.000 leke seicila. Ndarja e kapitalit themelues midis ortakeve eshte : Krenar Nuri Lasko 34 % (tridhjetë e kater); Resul Agush Resuli 33 % (tridhjetë e tre) dhe Enkeled Nuri Lasko 33 % (tridhjetë e tre)



NENI 5

Drejtimi i shoqerise "KAPPA-OIL" do te behet nga Keshilli Administrativ. Anetaret themelues te shoqerise jane anetare te Keshillit Administrativ. Administrator i shoqerise do te jete Krenar Nuri Lasko.

NENI 6

Shoqeria "KAPPA-OIL" per interesa ka te drejte te pranoj ortak, punetore e nepunes duke zbatuar akte ligjore e nenligjore per pagat e sigurimet shoqerore dhe kontraten e punes.

NENI 7

Veprimtaria financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo vitit. Administratori nxjerr bilancin i cili pasqyron aktivitetin financiare vjetor te shoqerise dhe ortaku i vetem vendos per shlyerjen e te gjitha detyrimeve dhe krijimin e fondeve rezerve te shoqerise, per fitimin e saj dhe menyren e administrimit te tij.

NENI 8

Shoqeria "KAPPA-OIL" mundet te shperbehet ne ato raste qe citohen shprehimisht ne statutin e saj si dhe ne aktet ligjore te organeve kopetente.

NENI 9

Rregullat e hollsishe per funksionimin e shoqerise jane percaktuar ne statutin e saj bashkangjitur ketij themelimi.

Tirane me,.....

O R T A K E T T H E M E L U E S

RESUL AGUSH RESULI ENKELED NURI LASKO KRENAR NURILASKO,

Resul Agush Resuli

Enkeled Nuri Lasko

Krenar Nuri Lasko



S T A T U T I
I
SHOQERISE TREGTARE "KAPPA-OIL" SH.P.K

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "KAPPA-OIL" krijohet sipas aktit themelimit

Per ta bere te mundur veprimtarine ekonomike e organizmin e kesaj shoqerie ne perputhje me Ligjin Nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr 7667 date 28.01.1993 " Per rregjistrin tregtar" dakorte te hartojne kete statut te cilin e kane perpiluar me kerkesat e ligjes per shoqerite tregtare me pergjegjesi te kufizuar si me poshte:

FORMA EMERTIMI

NENI 1

Shoqeria e krijuar eshte shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K).
Emertimi i shoqerise tregtare eshte : "KAPPA-OIL" SH.P.K

NENI 2

Shoqeria "KAPPA-OIL" eshte person juridik dhe fiton zotesi per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykatën e rrethit Tirane

NENI 3

Ortaket themelues te kesaj shoqerie derdhin kapitalin e tyre me qellim qe te perfitojne prej te ardhurave qe mundet te vijne nga veprimtaria e saj dhe te perballoj humbjen deri ne kufijte e vleres se kontributit ne kapitalin themelor.

SELIA.

NENI 4

Selia e shoqerise eshte **Shijak - Durres**, shoqeria mund te kete dege filiale, agjensi ose perfaqesi ne gjithe territorin e Shqiperise dhe jashte saj.



KOHEZGJATJA

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise eshte parashikuar per 30 (tridhjete)vjete.

OBJEKTI

NENI 6

Shoqeria "KAPPA-OIL " SH.P.K, ka si objekt te veprimtarise se saj :

- *- prodhim akumulatore
- *- prodhim perpunim vajra lubrifikuese
- *- tregeti me shumice e pakice, import ose export.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 7

Kapitali themelues i shoqerise ne momentin e krijimit te saj do te jete 100.000 (njqindemije) leke . Kapitali eshte i ndare ne 100 pjese me 1.000 leke seicila. Ndarja e kapitalit themelues midis ortakeve eshte : Krenar Nuri Lasko 34 % (tridhjete e kater); Resul Agush Resuli 33 % (tridhjete e tre) dhe Enkeled Nuri Lasko 33 % (tridhjete e tre)

NENI 8

Kapitali themeltar mund te rritet me shtimin e aktivitetit te shoqerise me pelqimin e ortakeve.


ORGANIZMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 9

Shoqeria do te drejtohet nga keshilli Administrativ, anetaret themelues jane anetare te Keshillit administrativ.

Administratori i shoqerise do te jete z. Krenar Nuri Lasko.

Ortaket kane ne kopetence te caktojne si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk jane ortak. Administratori ka per detyre organizmin dhe drejtimin e veprimtarise. Ai kryen te gjitha veprimet e administrimit ne interes te saj. Ne



marredheniet me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Administratori e humbet detyren e tij ne raste te prishjes se shoqerise, dhe kur eshte i zgjedhur kur shkarkohet nga ortaku themelues

NENI 10

Shoqeria "KAPPA-OIL" SH.P.K, mund te lidh kontrata me sektore shteterore, drejtperdrejte ne tregun e lire si dhe me persona fizik e juridik vendas edhe te huaj.

NENI 11

Ne veprimatrine e saj kontraktuale shoqeria perfaqsohet nga administratori ose persona te tjere te autorizuar. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 12

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal. afatet e derdhjes se tij, sigurimet shoqerore etj. Ajo ka te drejte te cel llogari likujduese prane bankave te vendit dhe te huaja dhe te kryej veprimtaria likujduese neper mjet tyre.

NENI 13.

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose ne valute te huaj. Shkembimin e monedhes kombetare me monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta bej ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose ne tregun e lire privat te valutes.

NENI 14

Per pasqyrimin e aktivitetit privat administratori ose persona te tjere te caktuar jane te detyrur te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas ligjit te vecante.

NENI 15

Veprimtaria ekonomike e shoqerise pasqyrohet ne perputhje me vitin kalendarik, ajo mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori ose persona te tjere te caktuar jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe ti depozitojne ato ne organin financiar te juridiksionit perkates.



NENI 16

Ortakët themelues vendosin për shtimin e ortakëve si dhe të personave të tjerë që do të punësohen në shoqëri

NENI 17

Marredhënit e punësimit brenda shoqërisë rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis paleve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punëdhënësi në librin e punës së shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e juridiksionit ku ushtron aktivitetin shoqëria. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të leshuar nga administratori. largimi lidhet me mbarimin e afatit të kontratës, për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.

NENI 18

Shoqëria mund të marrë truall për ndertime ose me qira si dhe objekte të ndryshme në pronësi duke përdorur kontratat përkatëse.

NENI 19

Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, detyrimeve të tjera ndaj shtetit, sigurimeve shoqërore dhe çdo detyrimi tjetër, fitimi mbetet në pronësi të ortakëve.

NENI 20

Shpërblerja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si humbja e kapitalit të shoqërisë, pamundësi veprimi ose me vendim të vetëm.

NENI 21

Në rast shpërblerja, ortakët vendosin mbi menyrat e likuidimit duke caktuar një ose më shumë likuidatore duke i caktuar edhe fuqitë që kanë.

NENI 22

Veprimtaria e shoqërisë do të konsiderohet e ligjeshme kur veprimet juridike-civile do të kryhen konform disponimeve në këtë statut dhe kurdoherë në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.



NENI 23.

Per cdo mosmarreshje te lindur midis ortakeve fillimisht synohet zgjidhja e saj me mirekuptim, ne rast te kundert gjykimi i saj behet ne Gjykatën e Tiranes.

NENI 24

Persa nuk shprehet ne kete statut zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare",ne vecanti dhe legjislacionit Shqiptar ne pergjithesi.

Statuti eshte hartuar ne kater kopje me fuqi te barabarte secila.

Ne Tirane sot me date

ORTAKET THEMELUES

RESUL AGUSH RESULI ENKELED NURI LASKO KRENAR NURI LASKO,

Resul Agushi *Enkeled Nuri Lasko* *Krenar Nuri Lasko*